VENDIM
Nr. 78, datë 9.9. 2014

PËR MIRATIMIN E KËRKESËS SË OSHEE SHA PËR KRYERJEN E INVESTIMIT NË NDËRTIMIN E N/STACIONIT 110/35/10 NË ÇOROVODË ME FUQI TË INSTALUAR 25 MVA

Në mbështetje të neneve 9 dhe 24 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, nenit 11 të rregullores "Për procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike", Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 9.9.2014 pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë OSHEE sh.a. për kryerjen e investimit në ndërtimin e një n/stacioni 110/35/10 me fuqi të instaluar 25 MVA, në Çorovodë dhe u njoh me informacionin e përgatitur nga grupi i punës,

KONSTATOI SE:

Aplikimi i OSHEE sh.a për planin e investimit në ndërtimin e n/stacionit 110/35/10 me fuqi të instaluar 25 MVA në Çorovodë me një vlerë të parashikuar prej 2 200 000 euro është në përputhje me kërkesat e neneve 10 dhe 13 të rregullores "Për procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike". Ky investim përbën një ndërhyrje të domosdoshme dhe të koordinuar teknikisht dhe në aspektin kohor të ndërtimit.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve

VENDOSI:

1. Të miratojë kërkesën e OSHEE sh.a. për kryerjen e investimit në ndërtimin e n/stacionit 110/35/10 në Çorovodë me fuqi të instaluar 25 MVA dhe me vlerë të parashikuar investimi 2 200 000 (dy milionë e dyqind mijë) euro.

2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit për njoftimin e OSHEE sh.a.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti